



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.576/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesuesi, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar Endrit Elshani, Xhevat Elshani, Nazlije Elshani paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Endrit Elshani, Xhevat Elshani, Nazlije Elshani, i paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën **31.08.2021** PZAP-i ka pranuar një apel nga Endrit Elshani, Xhevat Elshani, Nazlije Elshani, në të cilën pretendohet se KQZ e ka larguar nga lista e votuesve jashtë Kosovës pa të drejtë. Si provë apelit i ka bashkangjitur formularin e aplikimit, dokumente personale si dhe emalin e aplikimit në KQZ.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën ka theksuar se ankuesi me mbiemër Elshani (Endrit, Xhevat dhe Nazlije Elshani), që të gjithë me vendbanim në Gjermani, përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës (10 Korrik – 18 Gusht 2021), nuk kanë dërguar aplikacione për regjistrim. Gjithashtu ka theksuar se kërkimi i këtyre personave është bërë në tre emalit e krijuar për qëllim të aplikimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil*”. Në rastin konkret parashtruesi i Apelit nuk ka bashkangjitur në formularin për regjistrim drejtuar KQZ-së, ndonjë dokument valid të Republikës së Kosovës, e as me apelin drejtuar PZAP-së nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Paneli shqyrtoi me kujdes pretendimet e apeluesit në apel se i njëjti përmes emailit ka aplikuar për zgjedhjet lokale që do të mbahen me 17 Tetor 2021, mirëpo këto pretendime të apeluesve paneli i refuzoi si të pa bazuara. Në rastin konkret nuk kemi dëshmi nga ana e apeluesit se i njëjti ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë vendi, nuk kemi as dëshminë e dorëzimit të formularit për aplikim e as të dokumenteve valide që kërkohen me dispozita ligjore, prandaj në mungesë të provave paneli vendosi ta refuzoj apelin si të pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 576/2021 më datën 02.09.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.